



UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” GJILAN

UNIVERSITY “KADRI ZEKA” GJILAN

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

[www.upgj.org](http://www.upgj.org)

Rektori

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Nr. Ref. 01/378 Gjilan, më 10.05.2016

## **STANDARDDET E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË PËR**

**UNIVERSITETIN “KADRI ZEKA” GJILAN**

Gjilan, 2016

Standardet për sigurimin e cilësisë është dokumenti i rëndësishëm i zhvillimit të UKZ, i cili përcakton prioritetet bazë të sigurimit të cilësisë dhe mënyrat e realizimit të tij. Ky dokument, mund të rishikohet dhe ndryshohet periodikisht, poashtu të mund të shërbejë si dokument për hartim Rregullores së institucionit për procedurat e sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore do të jetë e bazuar në Standardet e sigurimit të cilësisë në Hapsirën Europiane të Arsimit të Lartë (Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area ESG).

UKZ është i vendosur në për të përbushur misionin e vet, universiteti është i vendosur në mënyrë permanente dhe konsistente të aspirojë avancim të cilësisë dhe integrim në sistemin dhe hapësirën e unifikuar të arsimit të lartë Evropian.

## **1. Standardi i organizimit strukturor**

UKZ duhet te jete përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë duhet të krijohet grup i cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UKZ, mbështetur në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Grupi i Cilësisë duhet të përbëhet nga *Zyra e Sigurimit të Cilësisë*, e ngritur pranë rektoratit të UKZ, dhe përfaqësues të cilësisë në çdo njësi akademike- Fakultete.

Grupi i cilësisë duhet të hartoje rregulloren e funksionimit të tij si dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit te cilësisë në njësitë përbërëse.

UKZ duhet te përcaktoje në buxhetin e institucionit fondet e nevojshme për ngritjen, mirëmbajtjen,përmirësimin e sistemit të cilësisë

Senati i UKZ duhet te miratoje të gjithë dokumentacionin për sistemin e cilësisë.

## **2. Standardi i vlerësimit të brendshëm të Cilësisë**

*Zyra e Sigurimit të Cilësisë* duhet te planifikoje organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Për të realizuar këtë duhet te ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore. Në rast nevoje,ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm duhet te ngrihet nga njësia përkatëse. Ai ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Vlerësimi i brendshëm duhet te realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Konkluzionet e vlerësimit të brendshëm duhet te mbështeten në analizën statistikore të të dhënavë, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuar me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët. Drejtuesit e njësive të vlerësuara duhet te publikojnë rezultatet e vlerësimit të kryer.

Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional duhet te organizohet si rregull një here në.... ?. Nëse është e nevojshme, njësia akademike- Fakulteti mund të organizojë vlerësimë të përleshme edhe më shpesh.

Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve duhet te përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.

*Zyra e Sigurimit të Cilësisë* në bashkëpunim me Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) duhet të organizoje trajnim të anëtarëve të grupit të vlerësimit. Për anëtarët e grupit të vlerësimit njësia duhet të marrë masat e sigurimit të kushteve të përshtatshme për realizimin e kësaj detyre.

Njësia duhet të këtë përgjegjësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për mbulimin e gjithë aktiviteteve të procesit të vlerësimit të brendshëm.

*Zyra e Sigurimit të Cilësisë* duhet te mbaje lidhje të vazhdueshme me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) për realizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm.

### **3. Standardi i rishikimit periodik te programit të studimit**

Fakulteti duhet te organizoje në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Dekani i fakultetit duhet te aktivizoje grupin e rishikimit, i cili duhet te jete përgjegjës për këtë proces. Gjatë këtij rishikimi vëmendje duhet t'i kushtohet:

- a. *rishikimit të shpërndarjes së krediteve për disiplinat apo grup - disiplinat përkatëse;*
- b. *rishikimit të programeve mësimore të lëndëve të veçanta;*
- c. *rishikimit të elementeve përbërës të disiplinave dhe ndarjen e krediteve ndërmjet tyre (lekcionare, seminare, detyra, projekte, laboratorë, etj.);*
- d. *rishikimi i rregullores së programit të studimit;*
- e. *rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës;*
- f. *rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës;*
- g. *rishikimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik;*
- h. *rishikimi i procedurave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit;*
- i. *rishikim i feedback-ut të marrë nga studenti.*

Realizimi me sukses i procesit të rishikimit duhet te kërkoje grumbullimin e të dhënave të nevojshme përgjatë vitit akademik. Dekanati i fakultetit duhet te organizojë procesin e tërheqjes së opinioneve të studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha disiplinat.

Mësimdhënësit në përfundim të vitit akademik duhet të japid një relation me shkrim për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për disiplinat përkatëse, duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje, si dhe në lidhje me procedurat e kontrollit të dijeve dhe rezultatet e marra.

Rektori dhe Prorektori për mësim, kërkime shkencore dhe çështje të studenteve duhet te kontrollojnë në vazhdimësi ecurinë e procesit mësimor, duke regjistruar të gjitha mangësitë në zhvillimin e mësimit, të cilat duhet te bëhen objekt në procesin e rishikimit.

#### **4. Standardi i regjistrimit, ruajtjes se të dhënave, raportimi**

Të gjitha të dhënat e grumbulluara sipas standardit te mësipërm, duhet te ruhen në një dosje të veçantë të programit të studimit në arkivin e fakultetit. Kjo dosje duhet t'i vihet në dispozicion grupit të rishikimit në momentin e realizimit të rishikimit të programit të studimit.

Raporti i rishikimit duhet te përcaktoje ndryshimet që duhet të bëhen në programin e studimit dhe rregulloren e tij mësimore, në procesin e implementimit, në bazën materiale e didaktike, në stafin akademik, në procedurat e kontrollit të dijeve e vlerësimit te studentëve, në procesin e marrjes së “feedback”-ut nga studentët.

Raporti i rishikimit të programit të studimit duhet te analizohet nga Senati, i cili duhet t'a miratoje atë. Rektorati duhet të marrë masat për zbatimin e planit të veprimeve sipas afateve të përcaktuara.



**Rektori  
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi**

A handwritten signature in blue ink over a horizontal line.